



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I MBIKËQYRJES FINANCIARE
BORDI

VENDIM

Nr. 57, datë 26.05.2017

PËR

**MIRATIMIN E RREGULLORES “MBI LLOGARITJEN E MBAJTJES NETO TË
MBULIMIT MAKSIMAL AGREGAT TË RREZIQEVE QË RRJEDHIN NGA
KONTRATAT E SIGURIMIT”**

Në bazë dhe në zbatim të nenit 14, pika 2, të Ligjit nr. 9572, datë 03.07.2006 “Për Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare”, i ndryshuar, si dhe të nenit 116, pikat 5, 6 dhe 7 të Ligjit nr. 52/2014 “Për veprimtarinë e sigurimit dhe risigurimit”, me propozim të Drejtorisë së Analizës së Riskut/Departamenti i Mbikëqyrjes Financiare, Bordi i Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare,

V E N D O S I:

1. Miratimin e Rregullores “Mbi llogaritjen e mbajtjes neto të mbulimit maksimal agregat të rreziqeve që rrjedhin nga kontratat e sigurimit”, sipas materialit bashkëlidhur.
2. Ngarkohet Drejtoria e Analizës së Riskut/Departamenti i Mbikëqyrjes Financiare për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETAR

Pajtim MELANI

DREJTOR I PËRGJITHSHËM EKZEKUTIV

Ervin KOÇI